

VENDIM
Nr.604, datë 10.9.2004

**PËR TRANSFERIMIN E MJEDISEVE TË DREJTORISË RAJONALE TË DOGANËS,
POGRADEC, NË PRONËSI TË BASHKISË PROGRADEC**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 5 e 7 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkisë së Pogradecit t’i kalojnë në pronësi mjediset e drejtorisë rajonale të doganës, Pogradec, për t’u përdorur si muze, sipas hartës treguese të regjistrimit, planimetrisë e planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Bashkisë së Pogradecit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano


KLARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)


ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJSHME	A. IDENTIFIKIMI I PASURISE	
	ZONA KADASTRALE <u>858</u>	NR. I PASURISE <u>4/52</u> VOL. <u>1</u> FQ. <u>1</u>
	INDEKSI I HARTES <u>858</u>	SIRKALLA <u>1350</u>
	ADRESA E PASURISE: Rrethi <u> </u> QRF <u> </u>	
	Rr. <u> </u> Nr. <u> </u> D. <u> </u> Ap. <u> </u>	
	D. KUFIZIMIET	
C. PROBARI		
V. <u> </u>		
L. <u> </u>		
J. <u> </u>		
P. <u> </u>		
D. Data: <u> </u> / <u> </u> / <u> </u> Ora: <u> </u>		




PLANIMETRIA E KATIT PERDHE
OBJEKTI: ZYRA DOGANE POGRADEC SH 1:100



PLANIMETRIA E KATIT PARE OBJEKTI: ZYRA DOGANE POGRADEC SH-I:100



VENDOSJA E DREJTORISE SE DOGANES POGRADEC LAGJA NR. 2 RR. "RESHIT ÇOLLAKU"
000 NOM PG-D-4. ZONA KADASTRALE 8581.



PROHA: GODINË 2KT. ATUAL
SIP. E PËRGJITHSHMË TËPUL. S=500m²
SIP. NDËRTESE S=180m²
KUEZIMET E PRONËS
VERI, TORTUAR RR. R. ÇOLLAKU
JUG RR. E LAGJES
LINDJE BANESË 2KT. A. D'FERIGHI
PERËNDIM RR. E SHKOLLËS